

Tiranë më, 16 Mars 2021

TERMA REFERENCE

Subjekti: **DIZENJIMI DHE NDËRTIMI I PLATFORMËS DIXHITALE www.nohatespeech.al**

Numri i ToR: **BBA/04/2021**

Projekti: **“FOL kundër gjuhës së urrejtjes”**

Afati i dërgimit të ofertës: **29 MARS 2021, ora 16:00 PM**

1. INFORMACION MBI “FOL kundër gjuhës së urrejtjes”

FOL kundër gjuhës së urrejtjes është një projekt i cili ka si qëllim të krijojë një mekanizëm kombëtar gjithëpërfshirës online, kundër gjuhës së urrejtjes me synimin që të informojë, të edukojë, të mbledhë të dhëna dhe të forcojë kapacitetet e praktikuesve në adresimin e gjuhës së urrejtjes.

Projekti synon që të rritet ndërgjegjësimi i publikut dhe të hapet një diskurs shoqëror për të ekspozuar rastet e gjuhës e urrejtjes, duke bërë thirrje për një qasje sektoriale dhe një mjedis për zhvillimin e narrativave në luftën kundër gjuhës së urrejtjes. Ky projekt zbatohet nga Organizata Përtej Barrierave dhe është mbështetur financiarisht nga Bashkimi Europian dhe Këshilli i Europës.

Objektivat e Projektit

- Të informojë dhe të edukojë publikun me njohuri në veprimin kundër gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit në Shqipëri duke përdorur një grup aktivitetesh dhe ndërhyrjesh të personalizuar për grupe të ndryshme të synuara.

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe



- Të krijojë një mekanizëm kombëtar interaktiv dhe gjithëpërfshirës online kundër gjuhës së urrejtjes, me një qëllim shumëfunktional në informim, edukim, mbledhjen e të dhënave dhe forcimin e kapaciteteve të praktikuesve në adresimin e gjuhës së urrejtjes.

2. QËLLIMI I SHËRBIMIT

Qëllimi specifik i kësaj thirrje është **dizenjimi dhe ndërtimi** i www.nohatespeach.al e cila do të jetë një platformë kombëtare dixhitale ndërvepruese për gjuhën kundër urrejtjes në Shqipëri, si dhe një mjet promovues, informativ dhe lehtësues. Platforma në internet synon të plotësojë boshllëqet e identifikuar më parë duke krijuar gjithashtu një hapësirë kolektive ku të gjithë mund të ndihen të lirë dhe të sigurt për t'u informuar, për të mësuar më shumë dhe për të mbështetur viktimat e gjuhës së urrejtjes. Kjo platformë do të jetë gjithashtu një hapësirë e me mjete edukative, një hapësirë për krijimin e kundër narrativave, një stacion ku informacioni për audiencën e gjerë sigurohet në gjuhë të thjeshtuar dhe të qartë. Platforma online do të ofrojë rritje të kapaciteteve në informacion, burime dhe mjete për të gjithë aktorët e interesuar. Një element i rëndësishëm i platformës është dhe ofrimi trajnimeve online përmes mënyrës e-learning dhe asinkron.

3. SPECIFIKIMET DHE KËRKESAT E SHËRBIMIT TË KËRKUAR

Përmes këtij shërbimi mbështetës, kontraktuesi Përtej Barrierave kërkon dizenjimin dhe ndërtimin e platformës dixhitale, me cilësi dhe rezolucion të lartë, në gjuhën Shqipe nën domainin www.nohatespeach.al, i cili është tashmë i blerë nga PB.

3.1. Struktura dhe përmbajtja e platformës.

Platforma do të ndërtohet mbi këto **5 komponentë kryesorë** me mundësi për tu përmirësuar gradualisht.

Komponenti 1: Informacioni i projektit: Shkëmbimi i informacionit miqësor dhe korrekt për përdoruesin se çfarë është gjuha kundër urrejtjes, si ta identifikojmë atë, si të reagojmë ndaj saj, ku të drejtohem, me kë të kontaktojmë, kur ka nevojë ta raportojmë, ku të mësojmë më shumë rreth tij (mjete të ndryshme, lajme të projektit etj.).



Komponenti 2: Raportimi i rasteve dhe mbledhja e të dhënave: Një hapësirë e dedikuar për qytetarët që kanë vuajtur gjuhë urrejtjeje, ku mund të raportojnë në mënyrë anonime dhe marrin informacione se si t'i adresojnë ligjërisht shqetësimet e tyre. Një tjetër funksion in këtij komponenti është prodhimi i statistikave si psh, sa raste janë raportuar, çfarë temash, etj.

Komponenti 3: Mekanizëm për trajnime online: Module trajnimi do të përfshihen në platformën që do të ndiqen në mënyrë asinkron nga të interesuarit, ku ata të kenë mundësi për të marrë informacione, kryer dhe ngarkuar detyra praktike, parë video apo link-s specifike, etj. Pjesëmaarrësit gjithashtu do të kenë mundësi të krijojnë profilin e tyre për të qenë pjesë e trajtimeve.

Komponenti 4: Librari: publikime të ndryshme mbi gjuhën kundër urrejtjes, studime, artikuj të ndryshëm nga vendi dhe bota, etj.

Komponenti 5: Forum diskutimi: Një hapësirë në formë forumi, ku vizitorët e platformës hapin tema dhe diskutojnë. Kjo hapësirë do të moderohet nga PB, në mënyrë që informacionet e vëna në diskutim të jenë të faktura dhe të vërteta, e njëkohësisht ti përmbahen qëllimit të gjithë platformës.

3.2. Kriteret teknike

Platforma dixhitale e gjuhës kundër urrejtjes në internet duhet të përdorë/mbështesë teknologjitë e mëposhtme të internetit dhe të infrastrukturës:

- Versioni i fundit PHP;
- Version i fundit MySQL;
- Përdorimi i kornizave më të fundit dhe platformave me burim të hapur;
- Mbështetja e niveleve të ndryshme të cache-s;
- Qasja me burim të hapur (open source) nga ana e serverit për të ekzekutuar aplikacionin;
- Hapësirë e mjaftueshme për të trajtuar të gjitha të dhënat e shërbimeve elektronike (e-services) dhe kërkesat e përdoruesve;
- Bazat e të dhënave dhe regjistrat e pakufizuar;
- Bandëidh të pakufizuar;
- Teknikat më të fundit për krijimin e aplikacioneve front end: Gjuhët e shënuara si HTML, CSS dhe JavaScript të aplikuara;



- Miqësore për përdorim në celular;
- Teknologjitë më të fundit të kriptimit të të dhënave të ndjeshme dhe fjalëkalimeve;
- Faqet dinamike dhe SEO miqësore;
- Aplikimi në internet dhe funksionalitetet e tij për tu menaxhuar brenda një Sistemi të Menaxhimit të Përmbajtjes (CMS);
- Mundësia për të integruar materiale video dhe audio në formatin standard (FLV, SWF, MP4, AVI, MP3, H.264 dhe WMA) dhe formate të tjera të njohura mediatike. Mundësia për të integruar materiale foto, video ose audio nga faqet e jashtme, hiperlidhjet, etj.
- Shërbimet e garancisë dhe mirëmbajtjes, duke përfshirë mirëmbajtjen dhe mbështetjen pas shërbimit deri në Dhjetor 2022.

3.3 Optimizimi i Motorëve të Kërkimit SEO dhe Analiza e faqes

Ofruesi i këtij shërbimi duhet të sigurojë optimizimin e motorëve të kërkimit dhe analizën e faqes me elementët e mëposhtëm.

- Hulumtimi dhe analiza përmes fjalëve kyçe;
- Analiza e sitit;
- Analiza konkurruese;
- Optimizimi i përmbajtjes së faqes;
- Optimizimi i kodit HTML;
- Dorëzimi i Motorëve të Kërkimit (motorë kërkimi falas)
- Shkëmbimi i links-ave;
- Raporti i renditjes në internet;

3.4 Mjetet dhe opsionet e platformës

Faqja ueb duhet të ketë këto mjete dhe opsione themelore:

- Mjetet e regjistrimit për përdoruesit, krijimin e profilit dhe panelin e përdoruesit;
- Mekanizmin për regjistrimin e rasteve të gjuhës së urryjtjes;
- Menaxhimi i përdoruesve: Nivele të ndryshme të hyrjes brenda platformës; Mekanizëm apo mjete për trajnime online në mënyrë asinkron (integrimi i platformave ekzistente dhe adaptim);

- Njoftimet me email dhe sistemi i konfirmimit
- Krijimi i formave të pakufizuara të uebit;
- Opsionet e kërkimit: Kërkimi me fjalë kyçe;
- Statistikat e përdorimit të platformës: Numri i individëve që përdorin shërbimet e platformës; klikimet; numri i raportimeve të bëra, mundësitë e krijuara, përdoruesit aktivë dhe pasivë; ndërlidhjet e bëra të bazuara në kauza /interesa ose kategori;
- Kategoritë e organizuara bazuar në informacionin e dhënë në pikën 3.1.

3.5 Ndërfaqja e pjesës së përparme (front end interface)

Platforma duhet të ketë një ndërfaqe të përparme që është miqësore për përdoruesit dhe i përgjigjet të gjitha pajisjeve.

3.6 Ndërfaqja e prapme (back end interface)

Backend-i i tabelave, konfigurimeve dhe regjistrimeve të të dhënave duhet të sigurohet me teknikat më të fundit për të ofruar siguri të lartë duke përdorur teknologji të kriptimit për të mos lejuar hyrjen e paautorizuar në të dhëna të ndjeshme. Strukturat e tabelave duhet të lexohen lehtë.

3.7 Kërkesat e sigurisë

Platforma duhet të ketë një nivel të lartë të sigurisë, kriptimin e të dhënave të ndjeshme, përdorimin e certifikatave SSL dhe parandalimin e hyrjes së paautorizuar në infrastrukturën e saj. Prandaj, ofruesi i shërbimit duhet të sigurojë dhe të marrë në konsideratë për të provuar dhe marrë masa për zhvillimin e kategorive të mëposhtme të çështjeve të sigurisë duke parandaluar/ trajtuar hyrjen e paautorizuar dhe duke siguruar mbrojtjen e të dhënave:

- Vlerësimi i Rrezikut;
- Vërtetimi (Authentication);
- Autorizimi dhe Kontrolli i Hyrjes;
- Menaxhimi i Sesionit;
- Vlerësimi i të dhënave dhe inputeve;
- Shkrimet e kryqëzuara (Cross Site Scripting)
- Mangësitë e injeksioneve të komandave;
- Mbingarkesa e buffer-it;
- Trajtimi i gabimeve;

- Logimi;
- Administrimi në distancë;
- Aplikim në Ueb dhe;
- Konfigurimi i serverit.

3.8 Transferimi i njohurive

Ofruesi i shërbimit duhet ti sigurojë kontraktuesit:

- Trajnimin e të paktën 3 prej anëtarëve të stafit të Përtej Barrierave, se si të menaxhojnë uebfaqen e re dhe CMS, si dhe krijimi i një udhëzuesi përdorimi të lehtë për t'u lexuar.
- Të sigurojë udhëzime për nevojat e host-imit, të dhe konfigurimeve të sigurisë, si dhe privilegjet dhe kontrollet e administrimit të faqes.

Ofruesi i shërbimit duhet të sigurojë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm pas përfundimit me sukses të detyrave, si më poshtë:

- Manuali i përdorimit të platformës dhe udhëzime specifike të nevojshme;
- Manuali i instalimit;
- Manuali i konfigurimit;
- Dokumentacionin me shkrim për kodimin dhe strukturën e tij;

4. PRODUKTET E DORËZUARA

Produktet që ofruesi i shërbimit do të dorëzojë si objekt i kësaj kontrate janë:

- a) Ofruesi i shërbimit duhet të demonstrojë një model (mock up) të platformës me të gjitha funksionet përgjatë fazës së zhvillimit të paktën deri në fund të muajit **Maj 2021**.
- b) Metodologjia përfundimtare dhe Wireframe (Layout Design) për platformën në internet dorëzohet, finalizohet dhe aprovohet nga Përtej Barrierave pas miratimit nga donatori të paktën deri në fund të muajit **Maj 2021**;
- c) Platforma e plotë dizajnohet, ndërtohet dhe lançohet në rrjet në mënyrë funksionale të paktën deri në fund të muajit **Korrik 2021**;



- d) Kodimi dhe dokumentet përkatëse si më lart i dorëzohen Përtëj Barrierave të paktën deri në fund të muajit **Gusht 2021**.
- e) Mirëmbajtja e platformës dhe përditësimi me materiale vazhdon deri në muajin **Dhjetor 2022**.

Të gjitha produktet do të konsiderohen të përfunduara në kohën kur Kontraktuesi jep aprovimin dhe pëlqimin përfundimtar.

5. METODOLOGJIA

Ofruesi i shërbimit duhet të sigurojë metodologjinë që do të përdoret për zhvillimin e platformës në internet, detajet për secilën fazë, së bashku me një plan paraprak të punës dhe piketat e përfundimit të detyrës. Ofruesi i shërbimit duhet të zhvillojë një **Wireframe (Layout Design)** për të demonstruar modelin dhe funksionalitetet e platformës deri në fund të muajit **Maj 2021**.

6. KOHËZGJATJA E SHËRBIMIT/KONTRATËS

Data e fillimit të kësaj kontrate është **1 Prill 2021** dhe data e përfundimit të shërbimit është **Dhjetor 2021**.

7. PROFILI I OFRUESIT TË SHËRBIMIT

- Ofruesi i shërbimit duhet të jetë një person juridik i regjistruar në Shqipëri;
- Të ketë të paktën 2 vjet eksperiencë pune për zhvillimin e platformave dhe faqeve të ndryshme në internet.
- Të demonstrojë të paktën 3 detyra apo shërbime të kryera në vitet e fundit;
- Të ketë kapacitete të përshtatshme me përvojë të pasur paraprake në këtë fushë;
- Të ketë njohuri të shkëlqyera për sigurinë e faqes në internet, shërbimet e mbajtjes së faqes (hostimit) në internet dhe zhvillimin e aplikacioneve të internetit;
- Aftësi të demonstruara për të krijuar dhe dizenuar përmbajtje vizuale dhe dixhitale që është e qartë, edukative, elegante dhe e aftë për të përcjellë dhe prezantuar produktet në një mënyrë tërheqëse për audiencën;
- Të ketë përvojë pune dhe aftësi të demonstruara për të krijuar përmbajtje për audiencë të ndryshme në internet (dërgoni me ofertën links apo portofole të mëparshme si shembuj të punës tuaj);

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



COUNCIL OF EUROPE



Implemented
by the Council of Europe

EUROPEAN UNION

CONSEIL DE L'EUROPE



- Përvojë pune në krijimin e identitetit vizual dhe brandi-min e platformave në internet (Përtej Barrierave do t'ju vërë në dispozicion logon dhe katalogun e ngjyrave të identitetit visual).

8. SI TË APLIKONI

Ju lutemi të paraqisni ofertën tuaj për këtë shërbim, së bashku me dokumentat e mëposhtme:

1. Ofertë të specifikuar (*sipas formatit bashkëngjitur*) të llogaritur në monedhën **Lekë** me dhe pa vlerën e TVSH-së.
2. Fotokopje të NIPT-it.
3. Portofolio me punë të ngjashme të mëparshme (të paktën 3 të tilla).
4. Adresën zyrtare, personin përgjegjës dhe kontaktet e plota të telefonit dhe e-mailit.

Plotësimi i kushteve teknike është domosdoshmëri.

9. PËRZGJEDHJA E OFERTËS

Vlerësimi dhe përzgjedhja e subjektit fitues do të bëhet bazuar mbi kriteret teknike dhe financiare.

a) kriteret teknike

- Eksperiencë të mëparshme në dizenjim dhe ndërtimin e produkteve të ngjashme dhe garantimin e kërkesave të nevojshme;
- Eksperienca e mëparshme e dhënies së shërbimeve të ngjashme organizatave të shoqërisë civile do të konsiderohet aset;

b) kriteret financiare

- Çmimi më i ulët për ofertat që plotësojnë kushtet teknike.

Subjekti i përzgjedhur do të njoftohet me email për nënshkrimin e kontratës përkatëse.



10. MODALITETET E PAGESËS

Pagesa do të kryhet sipas procedurës së brendëshme të kontraktuesit të përcaktuar në kontratën e bërë me subjektin fitues pas përzgjedhjes.

Pagësa do të bëhet me 2 transfertë bankare, ku 20 % do të transferohet pas dorëzimit metodologjisë përfundimtare dhe Wireframe (Layout Design) për platformën dhe aprovimit nga Kontraktuesi,
DHE

Transferta e dytë prej 80% pasi platforma është dizenuar, ndërtuar dhe lancuar në rrjet në mënyrë funksionale të plotë me aprovimin e Kontraktuesit.

Pagesa do të bëhet me **Bankë** në monedhën **Lekë**, pas dorëzimit të produkteve.

11. KU TË DËRGONI OFERTËN TUAJ?

Ju duhet të dërgoni **ofertën tuaj të specifikuar të firmosur dhe të vulosur në një letër me kokë të kompanisë** (*përdorni modelin e letrës bashkëngjitur*) së bashku me dokumentet mbështetëse të pikës 8, **VETËM ME E-MAIL office@beyondbarriers.org** brenda datës, **29 MARS 2021**. Në subjektin e e-mailit ju duhet të shkruani: **BBA/04/2021-** (emri i Subjektit aplikues).

Ju mund të dërgoni pyetjet tuaja më shkrim në adresën e mëposhtme brenda datës 19 Mars 2021.

Organizata Përtej Barrierave

Mail: office@beyondbarriers.org /irena.topalli@beyondbarriers.org

Adresa: Rr. Don Bosko, Pallati Gener 2, Hyrja 1, Kati 6, Ap 51-Tiranë

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



Implemented
by the Council of Europe